



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK Nr. i stat. 02 Broj. shifra Nr. pages	Nr. Prot. 03-02/3725/17 Br Prot. 03-02/3725/17 Prot No. 03-02/3725/17 Data 14.11.2017 Datum 14.11.2017 Date 14.11.2017
P - SHITINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY



Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.11.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2530/17 për z. Shaqir Demiri – Këshilltar komunal në Kuvendin Komunal të Mitrovicës, për shkak se ai tashmë nuk ushtron këtë funksion dhe nuk gjendet në mesin e zyrtarëve të lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur, me nr. protokoli AKK-03-02-2530/17 për Zyrtarin e lartë, z. Shaqir Demiri – Këshilltar komunal në Kuvendin Komunal të Mitrovicës, ka qenë një situatë e dyshuar me konflikt interesi për shkak se gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik zyrtarët e lartë nuk kanë të drejtë që njëkohësisht të ushtrjnë edhe funksion menaxhues në ndërmarrje private.

Agjencia kundër Korrupsionit e ka hapur rast të dyshuar, por gjatë procesit të hetimit është konstatuar se z. Demiri tashmë ka mbaruar mandatin e të qenurit Këshilltar komunal që është argumentuar me Formularin e Deklarimit të pasurisë pas largimit nga funksioni publik, që z. Demiri e ka bërë në Agjencinë kundër Korrupsionit me dt. 8.11.2017 (DP-03-5412-17) dhe tani ai nuk e ushtron këtë pozitë, që rrjedhimisht do të thotë se nuk është as në mesin e zyrtarëve të lartë publik. Me rrethanat aktuale kjo situatë nuk paraqet as lëndë hetimi, sepse aktualisht i njëjti nuk ushtron asnjë funksion tjetër që e klasifikon atë në mesin e zyrtarëve të lartë publik, dhe si rrjedhojë nuk kemi të bëjmë me konflikt interesi të kësaj natyre.


II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit


/ Shaip Havolli /

